

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSSH / Drejtoria e Tensionit të Lartë / Dega Teknike / Sektori i Mirëmbajtjes

SPECIALIST

Të sigurojë planifikimin, koordinimin dhe monitorimin efektiv të aktiviteteve të mirëmbajtjes për rrjetin 35kV dhe pajisjet e nënstacioneve, me synim rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe performancës së rrjetit të tensionit të lartë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton dhe ndjek zbatimin e planeve të mirëmbajtjes periodike (javore, mujore dhe vjetore) për linjat 35kV dhe pajisjet e nënstacioneve, në bashkëpunim me Njësitë TL.
- Monitoron realizimin e remonteve të planifikuara dhe evidenton devijimet nga plani.
- Ndjek dhe koordinon procesin e eliminimit të avarive në linjat 35kV dhe pajisjet e nënstacioneve, duke siguruar reagim të shpejtë dhe minimizim të kohës së ndërprerjes.
- Kryen kontrole dhe inspektime periodike në terren për vlerësimin e gjendjes teknike të rrjetit TL.
- Analizon performancën e ndërhyrjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara, duke hartuar raporte teknike dhe rekomandime për përmirësim.
- Siguron menaxhimin korrekt dhe arkivimin e dokumentacionit teknik sipas procedurave në fuqi.
- Bashkëpunon me sektorë të tjerë teknikë për përmirësimin e standardeve të mirëmbajtjes dhe rritjen e efikasitetit operacional.
- Kontribuon në përgatitjen e statistikave dhe raportimeve periodike për drejtimin.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë e arsimit të lartë në Inxhinieri (preferohet Elektrike, profil Sisteme Energjetike / Rrjete Elektrike).
- Eksperiencë pune në mirëmbajtje të rrjeteve elektrike ose nënstacioneve përbën avantazh.
- Njohuri të mira të rrjeteve 35kV dhe pajisjeve të nënstacioneve.
- Aftësi analitike për interpretimin e të dhënave teknike dhe performancës së rrjetit.
- Aftësi organizative dhe koordinuese.
- Aftësi për punë në terren dhe në kushte operationale.
- Njohuri në përdorimin e programeve MS Office dhe sistemeve të menaxhimit teknik.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.